



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:302903
Datë: 17.03.2025
Numri i dokumentit: 06997919

C.nr.4908 /23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit, Vegim Maloku, në çështjen juridike – kontestimore të paditësit NP I. e H. të Kosovës-I. SH.A me seli në Fushë Kosovë, te cilën e përfaqëson F. S.,shef i zyrës ligjore kundër të paditurve M.G...Rr..Zh. S. Komuna Pejë me bazë juridike për lirim prone, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seancës më dt. 17.03.2025, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I.** KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit NP I. e H. të Kosovës-I. SH.A me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurve M.G.Rr. Zh. S., Komuna Pejë, me bazë juridike për lirim prone, vlera e kontestit e pa përcaktuar, me numër të lëndës C.nr.4908/23.
- II.** SECILA palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Paditësi në këtë gjykatë, me dt.28.12.2023 ka parashtruar padi kundër të paditurës për lirim prone, vlera e kontestit e pa përcaktuar.

I autorizuari i paditësve me parashtrësën e datës 12.03.2025 ka bërë tërheqjen e padisë në këtë çështje kontestimore.

Gjykata palën e paditur nuk e ka njoftuar për këtë tërheqje të padisë, pasi që aktvendimi për përgjigje në padi së bashku me padinë dhe provat nuk është dërguar tek të paditurit pasi që

gjykata nuk ka mundur që të bëjë komunikimin e rregullt me palët e paditura andaj duke u bazuar në këtë gjendje faktike nuk është krijuar litispedenca sipas nenit 262.1 të LPK-së.

Sipas dispozitës së nenit 261 par 1 parashihet se *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi ku deri në momentin kur gjykata e ka pranuar parashitreses e paditësit për tërheqje të padis i padituri nuk ka paraqitur në gjykatë përgjigjen në padi”*, duke u bazuar në këtë gjendje faktike e mbështetur në dispozitat e lartëcekura Gjykata vendosi sikur së në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Lidhur me shpenzimet procedurale, është vendosë duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Andaj duke u mbështetur në dispozitën e nenit 261 par. 1, 3 dhe 4 e lidhur me nenin 387 pika c), të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:302903, C.nr.4908/23, **17.03.2025**

Gj y q t a r i

Vegim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par 4 të LPK-së.